

## KONTRATË SHITBLERJE (TRANSFERIM) AKSIONESH

E lidhur sot me datë 15 Janar 2024, ne Rrëshen në mes të mëposhtëshenuarve:

### a) "SHITËSI"

**Shoqëria "Malvini " Shpk**, person juridik shqiptar, regjistruar me datë 24.02.1996 pranë QKR-së, me NIPT J67902530C, me seli në adresën: Lagjja "Beselidhja", Rruga Gjergj Elez Alia, pallati Nr. 13, kati pare, hyrja Nr. 2, Lezhe, pëfaqësuar nga ortaku i vetëm Z. Pashk Paloka, shtetas shqiptar, lindur me 17.04.1968 ne Gjash, Lezhe, banues ne Lezhe, mbajtes i kartes se identitetit me Nr.G80417079C, madhorme zotësi të plotë juridike për të vepruar,

### b) "BLERËSI"

**Shoqëria Tregtare "Pi.Bi.Pi" sh.p.k** me Nr. NIPTI- L29506001P, seli në Pallati Nr.7, Shkalla Nr.1, kati 2, Apartamenti Nr.2. Rrëshen, Mirditë, person juridik shqiptar, regjistruar me datë 17.08.2012 pranë QKR-së, e përfaqësuar nga ortakët

-**Preng Përkeqi** i biri i Bibës dhe Mrikës, lindur në Kumbull Mirditë më 10.06.1938, banues në Rrëshen Mirditë, shtetas Shqiptar, me Nr. ID D80610070N, Nr. Kartë ID 034103699, që zotëron 49 % të aksioneve.

-**Nensi Bita**, e bija e Apostol dhe Lindita, lindur në Lushnje më 27.10.1993, banues në Tiranë, Me Nr. ID J36027032M, Nr. Pasaportë BC0501300. që zotëron 30 % të aksioneve

-**Veronika Cara**, e bija i Prengës dhe Lizës, lindur në Kumbull Mirditë më 15/02/1964, shtetas Shqiptar , Me Nr. ID G45215334P, që zotëron 7 % të aksioneve

-**Alpina Prendi**, e bija i Prengës dhe Lizës, lindur në Kurbnesh Mirditë më 09/08/1966, shtetas Shqiptar , Me Nr. ID G65809040E që zotëron 7 % të aksioneve

-**Nora Palokaj**, e bija i Prengës dhe Lizës, lindur në Kurbnesh Mirditë më 08/06/1972, shtetas Shqiptar , me Nr. ID H25608201F që zotëron 7 % të aksioneve.

Të cilet bënë hartimin e kesaj kontratë shitje (transferim) aksionesh, në bazë të Ligjit 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", dhe me vullnetin e tyre të lirë.

**Shoqëria Tregtare "BLAC ENERGY" sh.p.k** me Nr. NIPTI- L59024001B, me seli në Lagjja nr.1, Rruga Kryesore, Pallati nr. 4, Kati 1, Zona Kadastrale 3224, Nr. Pasurie 2/117 Rrëshen, Mirditë, është themeluar me datë 23/04/2015 me kapitali themeltar 100.000 (njëqind mijë lekë), me numr të përgjithshëm të kuotave 2 në të cilen aksioneret janë si me poshtë:

-**Shoqëria Tregtare "Pi.Bi.Pi" sh.p.k** me Nr. NIPTI- L29506001P, seli në Pallati Nr.7, Shkalla Nr.1, kati 2, Apartamenti Nr.2. Rrëshen, Mirditë, me vlerë të kapitalit 98.000, lekë me numri i pjesëve 1 dhe pjesëmarrja në përqindje 98 %. Shoqëria Tregtare "Pi.Bi.Pi" është blersi dhe që në këtë kontratë do l referohemi "blerësi"

-**Shoqëria Tregtare "Malvini" sh.p.k** me Nr. NIPTI- J67902530C, me seli në adresën: Lagjja "Beselidhja", Rruga Gjergj Elez Alia, pallati Nr. 13, kati pare, hyrja Nr. 2, Lezhe me vlerë të kapitalit

2.000, lekë me numri i pjesëve 1 dhe pjesëmarrja në përqindje 2 %. Shoqëria Tregtare "Malvini" është "Shitësi" dhe që në këtë kontratë do i referohemi "Shitësi".

"Shitësi" si ortak i vetëm deklaron pa asnjë pengesë, në pronësi dhe zotërim të plotë, sasinë e aksioneve që zotëron te shoqëria Tregtare "BLAC ENERGY" sh.p.k me seli në Lagjja nr.1, Rruga Kryesore, Pallati nr.4, Kati 1, Zona Kadastrale 3224, Nr. Pasurie 2/117 Rrëshen, Mirditë në masën 2 % ja shet "blerësit"

"Shitësi" me vullnet të lire dhe të plotë se bazuar ne të drejtën që buron prej tyre, dhe të drejtën që ai ka mbi to, ai i shet me transferim 2% të aksioneve të kësaj shoqërie, 1 kuotë, me vlerë 2,000 lekë (dymijë lekë), duke ja kaluar në pronësi dhe zotërim të plotë, karshi shumës së blerjes të gjithë të drejtat dhe detyrimet, aktivin dhe pasivin që buron nga ky kapital,

"Blerësi", karshi shumës 2,000 lekë (dy mijë lekë), shumë të cilën e ka shlyer plotësisht, dhe që i përgjigjet 2 % të vlerës së aksioneve.

Kështu "Shitësi" heq dorë nga çdo titull dhe e drejtë lidhur me zotërimin e aksioneve të mesipërperemendura dhe njeh dhe emeron "Blerësin" pronar dhe zotëruar të atyre aksioneve.

"Shitësi", nepermjet kësaj kontrate shitje aksionesh garanton si më poshtë :

- 1) Të gjitha aksionet e lartpermendura të "Shitësit", dhe të transferuara, janë të lira nga çdo barre, huamarrje, konfiskim, pretendime personash të tretë, gjithashtu garanton aksione të lira nga çdo detyrim ligjor.
- 2) "Shitësi" kalon tek "Blerësit" tërësisht 2% (dy) të kapitalit aksioner të "shoqërisë" në vlerën 2,000 lekë

Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate "Blerësi" behet pronar, zotëruar i 100 % të aksioneve të kësaj shoqërie, e barabartë me vlerë 100,000 lekë (njëqind mijë lekë),

"Shitësi" nuk ka asnjë të drejtë mbi aksionet e kësaj shoqërie pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Kjo kontratë shitje aksionesh hartohet në katër kopje të njëjta dhe nënshkruhet si më poshtë

"Shitësi" i Aksioneve

"Blerësi"t e Aksioneve

MALVINI Shpk

"Pi.Bi.Pi" sh.p.k

Pashk Paloka

Preng Përkeqi

Nensi Bitia



Veronika Cara

Alpina Prendi

Nora Palokaj

